

VENDIM
Nr. 295, datë 24.4.2026

PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 769, DATË 13.12.2024, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR TRANSFERIMIN TE KORPORATA E INVESTIMEVE SHQIPTARE TË PRONAVE SHTETËRORE PËR REALIZIMIN E PROJEKTIT TË INVESTIMIT ‘RIJETËZIMI I STADIUMIT ‘SELMAN STËRMASI’, TIRANË’”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 1, të nenit 7, të ligjit nr. 71/2019, “Për Korporatën e Investimeve Shqiptare”, dhe në zbatim të shkronjës “b”, të pikës 1, të kreut II, të vendimit nr. 137, datë 6.3.2024, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e kriterëve dhe të procedurës për dhënien e pronës shtetërore me qira, enfitëozë, *leasing*, shitje, përdorim si kolateral dhe të përdorimit në forma të tjera nga ana e Korporatës së Investimeve Shqiptare”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Ekonomisë dhe Inovacionit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 769, datë 13.12.2024, të Këshillit të Ministrave, “Për transferimin te Korporata e Investimeve Shqiptare të pronave shtetërore për realizimin e projektit të investimit ‘Rijetëzimi i stadiumit ‘Selman Stërmasi’, Tiranë’”, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

a) Në pikën 2 bëhen shtesa dhe ndryshimi i mëposhtëm:

i. Pas fjalëve “... për të vepruar si zhvillues ...” shtohen “... nëpërmjet instrumentit ligjor të sipërmarrjes ...”;

ii. Fjalët “... vendimeve nr. 95, datë 9.9.2024 dhe nr. 112, datë 8.10.2024 ...” zëvendësohen me “... vendimeve nr. 95, datë 9.9.2024, nr. 112, datë 8.10.2024 dhe nr. 36, datë 30.3.2026 ...”.

b) Në fund të pikës 7 shtohet fjalia, me këtë përmbajtje:

“Ngarkohet Korporata të kryejë procesin e konsolidimit të pronave, të përcaktuara në shtojcat nr. 1 dhe nr. 2, në rast se konstatohet mospërputhje midis gjendjes faktike dhe ligjore të pronës.”.

c) Në shtojcën nr. 2, bashkëlidhur vendimit, bëhen shtesat e mëposhtme:

i. Në titull, pas fjalës “... publik ...” shtohen fjalët “... dhe privat ...”;

ii. Shtohen pronat, sipas tabelës që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Ngarkohen Ministria e Ekonomisë dhe Inovacionit, Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Bashkia Tiranë dhe Korporata e Investimeve Shqiptare për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

Zona kadastrale	Nr. i pasurisë	Sip. e pasurisë (m ²)	Nga sip.		Institucioni me pronësi/ përgjegjësi administrimi
			Truall (m ²)	Ndërtesë (m ²)	
8270	1/301	90	90	0	shtet
8270	1/302	54	-	-	shtet
8270	1/303	93	-	-	shtet
8270	1/304	87	-	-	shtet